



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-11076/22
Kaçanik, 29.04.2022

Në bazë të Nenit 40.3 e Ligjit Nr.03/L040- Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 53 pika 1 dhe 3 e Ligjit Nr.05/L-031 -Për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr. 20/21 Qershor 2016), të Propozim Vendimit të Kryesuesit të Kuvendit në konsultim me Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 Prill 2022, merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01NR. 327/09 - PËR BARTJEN(DELEGIMIN)E KOMPETENCËS, KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.327/09 i datës 30.01.2009 - Për Bartjen (Delegimin) e Kompetencës për Lejimin e Ndërrimit të Destinimit të sipërfaqeve të vogla të klasit V (pestë) dhe VI (gjashtë) të tokës bujqësore në tokët ndërtimore, Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Me shfuqizimin e vendimit nga pika 1. e këtij vendimi, Kuvendi i Komunës e tërheqë delegimin e kompetencës për Lejimin e Ndërrimit të Destinimit të sipërfaqeve të vogla të klasit V (pestë) dhe VI (gjashtë) të tokës bujqësore në tokët ndërtimore, nga Komitetit për Politikë dhe Financa.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 pas regjistrimit në zyrën e protokollit në MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Komiteti për Politikë dhe Financa,
3. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
4. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë; dhe
5. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly
01Nr.327/09
Kaçanik, 30.01.2009

Kuvendi i Komunës Kaçanik në bazë të nenit 40.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03 L-040, të propozim vendimit të kryetarit të komunës 01Nr.327/09 prej datës: 15.01.2009, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30.01.2009, merr :

V E N D I M **PËR BARTJEN(DELEGIM) KOMPETENCË**

I.

Me këtë Vendim i **BARTET (delegohet) KOMPETENCA** për Lejimin e Ndërrim Destinimit të Sipërfaqëve të vogla të klasit V(pestë) dhe VI(gjashtë) të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore, Komitetit për Politikë dhe Financa.

II.

Kompetencën e përcaktuar si në pikën I të këtij Vendimi, Kuvendi i Komunës ia Bartë(delegon) Komitetit për Politikë dhe Financa nga dita e marrjes së këtij Vendimi e deri më Hartimin e Planit Hapësinor.

III.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, Bartjen e Kompetencës së përcaktuar , mund ta tërheqë edhe para afatit të përcaktuar si në pikën II. të këtij Vendimi , dhe atë në çdo kohë kur e shfjellë të arsyeshme dhe të nevojshme.

IV.

Obligohet Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, që Kërkesat për Ndërrim Destinimi të sipërfaqeve të vogla të klasit V(pestë) dhe VI (gjashtë) të Tokës Bujqësore në atë Ndërtimore, të ia propozoj Komitetit për Politikë dhe Financa për shqyrtim dhe vendosje.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

VI.

Me këtë vendim njotohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

